

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

viti 2022

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	29.03.2022	Ne baze te ligjit nr. 190 dt 18.09.2014 “Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare,” neni 3, kerkojme te informohemi dhe te na vihet ne dispozicion dokumentet zyrtare, lidhur me cshtjen penale qe ben fjale per shqyrtimin ne Apel, te ceshtjes penale ndaj E ose I.D me objekt “Lirim me Kusht”.	04.04.2022	Ne pergjigje te kerkeses Tuaj,me te cilen kerkuat te informoheni dhe t’Ju vihen ne dispozicion dokumentet zyrtare lidhur me “ <i>ceshtjen penale qe ben fjale per shqyrtimin ne Apel, te ceshtjes penale ndaj E ose I. D me objekt “Lirim me Kusht”</i> ”Ju informojme se : Ne date 31.01.2020, eshte regjistruar ne Gjykatën e	E plote	Nuk ka

¹Numrarendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		<p>1.Kerkojme nga ana juaj, te na vihet ne dispozicion informacion mbi ecurine e kesaj dosje deri ne kete periudhe?</p> <p>2.A ka perparesi, kjo ceshtje per tu gjykuar me shpejt nga Gjykata e Apelit Tirane?</p>		<p>Apelit Tirane ceshtja penale me nr.2020 sistemi, nr. akti, qe lidhet me ankimin e prokurorit, ndaj vendimit nr. 1/123 Akti, date 14/01/2020 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje, me te cilin u pranua kerkesa e te denuarit E.D per lirimin e tij me kusht.Po ne date 31.01.2020, pas shortit elektronik per percaktimin e gjyqtarit relator te ceshtjes, u caktua si i tille, gjyqtari Z. Genti Shala.Per shkak te emerimit ne Gjykatën e Apelit Tirane, te dy gjyqtareve, si dhe per shkak te numrit te larte te dosjeve gjyqesore qe presin te gjykohen, me vendimin nr.1, date 31.01.2022 te Keshillit te Gjykates se Apelit Tirane “Per rindarjen me short te ceshtjeve penale”, dosja eshte rishortuar dhe per rrjedhoje eshte caktuar si gjyqtare relatore, Znj. Emona Muci (Vendimi nr.1, date 31.01.2022 i Keshillit te Gjykates se Apelit Tirane eshte i publikuar ne faqen e webit te Gjykates se Apelit</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Tirane).- Deri ne daten 29.03.2022 (data e paraqitjes se kerkeses Tuaj), ceshtja nuk eshte planifikuar per gjykim.</p> <p>2.Ju informojme se, si ceshtjet penale, ashtu edhe ato civile gjykohen ne perputhje me normat procedurale, qe rregullojne gjykimin ne apel. Kjo do te thote se edhe ceshtja, per te cilen kerkohet informacioni u nenshtrohet ketyre rregullave</p>		
2	01.04.2022	<p>Duke punuar per një material mbi vendimet e gjykatave që përmbysin dënimet e rënda ndaj anëtareve të bandave kriminale. Për nevoja të këtij shkrimi ne kemi nevojë të na vini në dispozicion disa të dhëna dhe tu përgjigjeni disa pyetjeve.</p> <p>Sa është numri i të burgosurve që janë liruar me kusht në 10 vitet e fundit për këto vepra penale : vrasje, trafik droge, trafik ndërkombëtar droge,grup i strukturuar kriminale dhe trafikimi të qënieve njerëzore?</p> <p>Cili është qëndrimi që ka mbajtur institucioni juaj për kërkesën e bërë nga këta të burgosur?</p>	11.04.2022	<p>Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, është dërguar shkresa me lëndë: “Kërkese për informacion dhe vënie në dispozicion të informacionit apo dokumentacionit”.</p> <p>Ju informojmë se pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga verifikimi i kryer nga ana jonë, për periudhën 2010-2022 janë gjykuar çështjet penale me objekt: “Lirim me kusht”, për veprat penale: “Vrasje”, “Trafik droge”, “Trafik ndërkombëtar droge”, “Grup i strukturuar kriminal” dhe</p>	E plote	Nuk ka

			<p>“Trafikim të qënieve njerëzore”, si më poshtë vijojnë:</p> <p>VITI 2022 Trafikimi lëndë narkotike 3</p> <p>Vrasje 1</p> <p>VITI 2021 Trafikimi lende narkotike 1</p> <p>VITI 2020 Trafikimi lënde narkotike 1</p> <p>VITI 2019 Trafikimi lende narkotike 6</p> <p>Vrasje 2</p> <p>VITI 2018 Vrasje 4</p> <p>Shfrytezim prostitucioni ne rrethana renduese 1</p> <p>VITI 2017 Trafikimi lende narkotike 1</p> <p>VITI 2016 Vrasja 5</p> <p>Shfrytezim prostitucioni ne rrethana renduese 2</p> <p>VITI 2015</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Vrasje 8</p> <p>Trafikimi lende narkotike 1</p> <p>VITI 2014 Vrasje 9</p> <p>Trafikimi lende narkotike 2</p> <p>VITI 2013 Vrasje 9</p> <p>Trafikimi lende narkotike 6</p> <p>VITI 2012 Vrasje 8</p> <p>Trafikimi lende narkotike 2</p> <p>VITI 2011 Vrasja 11</p> <p>Trafikimi lende narkotike 3</p> <p>VITI 2010 Vrasje 4</p> <p>Trafikimi lende narkotike 2</p>		
--	--	--	--	---	--	--

3	29.04.2022	Vënien në disozicion të vendimit date 04.11.2010 te gjykates se Apelit Tirane, me pale padites G.N dhe i paditur D.P.P.SH	04.05.2022	<p>Në përgjigje të kërkeses tuaj, bashkëlidhur do të gjeni vendimin e anonimizuar date 04.11.2010.</p> <p>Sjellim në vëmendjen tuaj se qasja në këtë informacion duhet të trajtohet për qëllime studimore ose statistikore në respektim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” por edhe të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemim gjyqësor”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Udhëzimit Nr. 31 datë 27.12.2012 “Për</p>	E plote	Nuk ka

				<p>përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare dhe artistike”, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Udhëzimit Nr. 9 datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, të ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>		
4	06.06.2022	<p>Pyetja nr. 1: Si është gjendja e tanishme e Gjykatës së Apelit, lidhur me mangësitë pas shkarkimit të gjyqtarëve?</p> <p>Pyetja nr. 2 : Kur parashikohet që Gjykata e Apelit të funksionojë në formën e saj optimale pas reformës në drejtësi?</p> <p>Pyetja nr. 3: Sa është numri i çështjeve të mbetura stok?</p> <p>Pyetja nr. 4 : Çfarë po bën Gjykata e Apelit për të zgjidhur problemet e saj?</p>	08.06.2022	<p>1.Organika e trupës gjyqësore të kësaj gjykate është 31 gjyqtarë. Për shkak të zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të dorëheqjeve të gjyqtarëve, si dhe të daljes në pension të tyre, numri i gjyqtarëve vijoi të pakësohet për disa vite resht. Evidentohet se për gati një vit, kjo gjykatë e kreu funksionin me vetëm gjashtë gjyqtarë.</p> <p>Aktualisht, situata po përmirësohet pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përfunduar procedurën për ngritjen në detyrë të shtatë gjyqtarëve të rinj, të cilët i janë bashkuar</p>	E plote	Nuk ka

				<p>trupës ekzistuese. Po ashtu me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit u konfirmua edhe gjyqtari Fatri Islamaj, i cili ishte i pezulluar për shkak të vendimit të marrë më herët nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Për rrjedhojë aktualisht ushtrojnë detyrën 14 gjyqtarë</p> <p>2. Reforma në drejtësi, sikurse dihet, po vijon dhe nuk ka përfunduar. Sa i përket Gjykatës së Apelit Tiranë, pritet vetëm përmirësim i situatës dhe shtim i gjyqtarëve, sapo KLGJ të përfundojë procedurat për vakancat tashmë të shpallura, si dhe të vijojë me shpalljen e vendeve të tjera vakante.</p> <p>Ndërkohë, pritet të miratohet harta e re gjyqësore e cila do të riorganizojë edhe gjykatat e apelit. Në këto kushte, është e vështirë të përcaktohet me saktësi koha se kur gjykata do të mund të jetë me organikën e saj të plotë.</p> <p>3. Në Gjykatën e Apelit Tiranë presin të gjykohen 18.967 çeshtje te karakterit civil dhe penal.</p>		
				<p>Penale 5984</p> <p>Civile 7801</p>		

				<p>Rivendosje 4952 Masa Sigurimi 13 Njohje vendimi huaj 200</p> <p>4. Gjykata e Apelit, si edhe çdo gjykatë tjetër, ushtron funksionin për dhënien e drejtësisë dhe kjo është e vetmja gjë që ajo mund të bëjë. Vetë gjykata nuk ka një problem (nëse do i referohemi kuptimit strikt të fjalës), por trupa gjyqësore është e shqetësuar për shkak të pamundësisë objektive për të gjykuar në afate të shpejta, çështjet që regjistrohen në apel. Kuptohet se me gjithë përpjekjet e trupës dhe administratës, numri me të cilin funksionoi për shumë kohë gjykata (pesë herë më i vogël nga organika), shpjegon arsyen për të cilën është akumuluar stoku i dosjeve. .</p>		

¹Numri i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

¹Data e regjistrimit të kërkesës

¹Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹Data e kthimit të përgjigjes

¹Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹Përgjigja jepet plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

¹Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.